

**LIGJ**  
**Nr.9975, datë 28.7.2008**  
**PËR TAKSAT KOMBËTARE\***

*(Ndryshuar me ligjin nr. 10065, datë 29.1.2009; nr.10 131, datë 11.5.2009; nr.10145, datë 28.9.2009; nr.10280, datë 20.5.2010; nr.10 458, datë 21.7.2011; nr.83/2012, datë 13.9.2012; nr.120/2013, datë 18.4.2013; nr.178, datë 28.12.2013; nr. 86/2014, datë 17.7.2014; nr.157, datë 27.11.2014; nr.141/2015, datë 17.12.2015; nr.127/2016, datë 15.12.2016)*

*(i përditësuar)*

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

**Qëllimi**

*(ndryshuar me ligjin nr. 86/2014, datë 17.7.2014)*

Ky ligj përcakton llojet e taksave dhe tarifave kombëtare që zbatohen në Republikën e Shqipërisë, nivelin e taksave kombëtare, procedurat e llogaritjes, të arkëtimit dhe transferimit në Buxhetin e Shtetit ose në buxhetin e njësisve të qeverisjes vendore të taksave dhe tarifave kombëtare, si dhe detyrimet që kanë agjentët e taksave dhe tarifave kombëtare.

Neni 2

**Përkufizime**

*(ndryshuar fjalë në pikën 3 me ligjin nr.178, datë 28.12.2013)*

*( ndryshuar me ligjin nr. 86/2014, datë 17.7.2014)*

*(shtuar pika 5 me ligjin nr.141/2015, datë 17.12.2015)*

*(ndryshuar shkronja "b" e pikës 5 me ligjin nr.127/2016, datë 15.12.2016)*

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. "Taksapagues" është çdo individ, person fizik ose juridik, vendas apo i huaj, i cili është i detyruar të paguajë njërën nga taksat kombëtare, të përcaktuara në këtë ligj.
2. "Taksë" është pagesa e detyrueshme dhe e pakthyeshme në Buxhetin e Shtetit që paguhet nga çdo person apo nëpërmjet një agjenti që ushtron një të drejtë publike apo përfiton një shërbim publik në territorin e Republikës së Shqipërisë.
3. "Tarifë" është një pagesë, që një individ, person fizik apo juridik, bën drejtpërdrejt

---

\* Ligji nr.9975, datë 28.7.2008 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 128, datë 4 gusht 2008.  
Ligji nr.10 065, datë 29.1.2009 është botuar në Fletoren Zyrtare nr.9, datë 9 shkurt 2009.  
Ligji nr.10 131, datë 11.5.2009 është botuar në Fletoren Zyrtare nr.86, datë 12 qershor 2009.  
Ligji nr. 10 145, datë 28.9.2009 është botuar në Fletoren Zyrtare nr.144, datë 12 tetor 2009.  
Ligji nr. 10 280, datë 20.5.2010 është botuar në Fletoren Zyrtare nr.73, datë 29 qershor 2010.  
Ligji nr.10458, datë 21.7.2011 është botuar në Fletoren Zyrtare nr.107, datë 9 gusht 2011.  
Ligji nr.83/2012, datë 13.9.2012 është botuar në Fletoren Zyrtare nr.127, datë 1 tetor 2012.  
Ligji nr.120/2013, datë 18.4.2013 është botuar në Fletoren Zyrtare nr.67, datë 3 maj 2013.  
Ligji nr.178, datë 28.12.2013 është botuar në Fletoren Zyrtare nr.203, datë 30 dhjetor 2013.  
Ligji nr. 86/2014, datë 17.7.2014 është botuar në Fletoren Zyrtare nr.126, datë 11 gusht 2014.  
Ligji nr.157, datë 27.11.2014 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 195, datë 24 dhjetor 2014.  
Ligji nr.141/2015, datë 17.12.2015 është botuar në Fletoren Zyrtare nr.252, datë 22 janar 2016.  
Ligji nr.127/2016, datë 15.12.2016 është botuar në Fletoren Zyrtare nr.250, datë 27 dhjetor 2016.

apo nëpërmjet një agjenti tek administrata tatimore qendrore. Paguesa bëhet në shkëmbim të një shërbimi specifik të marrë, të mire publike specifike të përdorur apo të drejte të dhënë.

4. “Agjent i taksave dhe tarifave” është personi i cili, sipas kërkesave të këtij ligji, është përgjegjës për llogaritjen, arkëtimin dhe transferimin në llogaritë e drejtorive rajonale tatimore, për t’u transferuar, më pas, në Buxhetin e Shtetit, të të ardhurave nga taksat dhe tarifatat kombëtare.

5. “Automjet luksoz” konsiderohet autovetura deri në 4+1, e cila plotëson të paktën njërin nga kushtet e mëposhtme:

- a) cilindratën të barabartë ose më të madhe se 3000 cm<sup>3</sup>; ose
- b) vlerën/çmimin të barabartë ose më shumë se 5 000 000 lekë.

### Neni 3

#### **Llojet e taksave kombëtare**

*(ndryshuar pikat 3 dhe 6 me ligjin nr.10280, datë 20.5.2010)*

*(ndryshuar pikat 2 dhe 6 me ligjin nr.10458 datë 21.7.2011)*

*(shtuar pika 8 me ligjin nr.83/2012, datë 13.9.2012)*

*( ndryshuar pika 8, shtuar pika 8.1 me ligjin nr.178/2013, datë 28.12.2013)*

*(shtuar pika 9 me ligjin nr. 86/2014, datë 17.7.2014)*

*( ndryshuar pikat 2, 6, shtuar pika10 me ligjin nr.157, datë 27.11.2014)*

*( shtuar pika 11 me ligjin nr. 141/2015, datë 17.12.2015)*

*( ndryshuar pikat 2,6 me ligjin nr. ligjin nr.127/2016, datë 15.12.2016)*

Taksat kombëtare janë:

1. Taksa portuale.
2. Taksa e qarkullimit për benzinën (sipas kodeve tarifore të NKM-së 2710 12 41; 2710 12 45; 2710 12 49; 2710 12 51; 2710 12 59) dhe për gazoilin (sipas kodeve tarifore të NKM-së 2710 19 31; 2710 19 35; 2710 19 43; 2710 19 46; 2710 19 47; 2710 19 48), si dhe për benzinën ose gazoilin që gjendet në përmbajtjen e biokarburantit (sipas kodeve tarifore të NKM-së 27102011 deri në kodin 27102019, 27102090, si dhe klasifikimin në nënkreun 38 26 00).
3. Taksa e mjeteve të përdorura të transportit.
4. Taksa e rentës minerare.
5. Taksa e akteve dhe e pullës.
6. Taksa e karbonit për benzinën (sipas kodeve të NKM-së 2710 12 41; 2710 12 45; 2710 12 49; 2710 12 51; 2710 12 59), për gazoilin (sipas kodeve të NKM-së 2710 19 31; 2710 19 35; 2710 19 43; 2710 19 46; 2710 19 47; 2710 19 48), për qymyrin (sipas kërësive të NKM-së 2701; 2702), për vajgurin (sipas kodeve tarifore të NKM-së 27 10 19 11 deri në 27 10 19 29), për solarin (sipas kodeve të NKM-së 2710 19 62 deri në 2710 19 68), për mazutin (sipas kodeve të NKM-së 2710 19 62 deri në 2710 19 68) dhe për koks naftë (sipas kodeve të NKM-së 2713 11 00; 2713 12 00), si dhe për benzinën ose gazoilin që gjendet në përmbajtjen e biokarburantit (sipas kodeve tarifore të NKM-së 27102011 deri në kodin 27102019, 27102090, si dhe klasifikimin në nënkreun 38 26 00).
7. Taksa e ushtrimit të veprimtarisë së peshkimit.
8. Taksa e ambalazheve të plastikës dhe të qelqit.
- 8.1. “Ambalazh” është çdo material paketues, që shërben për paketimin e produkteve, i cili mund ta mbulojë tërësisht ose pjesërisht atë. Ai e mbron atë nga ndotja, infeksionet, si dhe nga ndikimet që ulin cilësinë dhe/ose vlerën e tij dhe e bën të përshtatshëm për transport, tregtim e përdorim. Një ambalazh mund të përmbajë disa njësi ose tipa ambalazhesh.
9. Taksa mbi të drejtën e përdorimit të truallit shtetëror në përdorim.
10. Taksa mbi primet e shkruara, me përjashtim të primeve të sigurimit për produktet e jetës, shëndetit në udhëtim dhe kartonit jeshil.
11. Taksë regjistrimi fillestar dhe taksë e përvitshme për automjetet luksoze.

#### Neni 4

##### **Niveli i taksave kombëtare**

*(shfuqizuar fjalia e fundit e pikës 2 dhe ndryshuar pika 6 me ligjin nr.10 065, datë 29.1.2009)*

*(ndryshuar pikat 2, 3, 4, 6 me ligjin nr.10280, datë 20.5.2010)*

*(ndryshuar pikat 2, 3, 6 me ligjin nr.10 458, datë 21.7.2011)*

*(shtuar pika 8 me ligjin nr.83/2012, datë 13.9.2012)*

*(ndryshuar pika 3 me ligjin nr. 120/2013, datë 18.4.2013)*

*(ndryshuar pikat 2, 8 me ligjin nr. 178/2013, datë 28.12.2013)*

*(shtuar pika 9 me ligjin nr. 86/2014, datë 17.7.2014)*

*(ndryshuar pikat 2,4, shtuar pika 9 me ligjin nr.157, datë 27.11.2014)*

*(ndryshuar pikat 4, 5, 9, shtuar pika 11 me ligjin nr. 141/2015, datë 17.12.2015)*

*(ndryshuar pikat 2,3, 4, 8, me ligjin nr.127/2016, datë 15.12.2016)*

1. Taksa portuale është 1 euro. Kjo taksë paguhet, për çdo prekje, për të gjitha anijet që prekin portet dhe radat e Republikës së Shqipërisë e që kryejnë veprime tregtare.

2. Taksa e qarkullimit mbi benzinën dhe gazoilin caktohet në masën 27 lekë/litër për benzinën dhe 27 lekë/litër për gazoilin. Kjo taksë paguhet për sasinë e benzinës dhe të gazoilit të importuar apo të prodhuar në vend, me përjashtim të sasisë së benzinës dhe të gazoilit të prodhuar në vend, por të eksportuar jashtë territorit të Shqipërisë.

3. Taksa vjetore e mjeteve të përdorura është e vlefshme për 365 ditë dhe caktohet sipas formulës: Cilindrata në  $\text{cm}^3$  x koeficienti fikse sipas vjetërsisë x taksa fikse për llojin e karburantit. Taksa fikse për llojin e karburantit është 12,5 lekë për naftën dhe 10 lekë për benzinën. Koeficienti sipas vjetërsisë së mjetit është si në shtojcën 1 bashkëlidhur këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij. Mjetet me vjetërsi nga 0-3 vjet nuk janë subjekt i kësaj takse. Detyrimi për pagimin e taksës i takon pronarit të mjetit. E ardhura nga taksa, për çdo rast, mbledhet nga strukturat e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, drejtoritë rajonale, para kryerjes së kontrollit teknik vjetor të detyrueshëm të mjetit.

Kontrolli teknik i mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove të tyre kryhet brenda periudhës së vlefshmërisë 365-ditore të taksës vjetore të mjeteve të përdorura.

Pronari i mjetit, i cili nuk kryen pagesën e kësaj takse brenda 10 ditëve nga mbarimi i afatit të vlefshmërisë së parashikuar, detyrohet të paguajë një gjobë prej 5 për qind të shumës së detyrimit të papaguar për çdo muaj vonesë, por jo më shumë se 25 për qind për çdo vit. 18 për qind e të ardhurave vjetore nga kjo taksë i kalojnë buxhetit të qeverisjes vendore. Procedura e ndarjes së të ardhurave me buxhetet e njësisve të qeverisjes vendore përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave, bazuar në numrin e mjeteve të regjistruara sipas njësisve të qeverisjes vendore.

4. Taksa e rentës minerare caktohet sipas shtojcës nr. 2, që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij. Përqindja e rentës minerare për përmbajtjen e mineralit metalor në nënproduktin mineralar është në masën sa 1/2 e normës së rentës së përcaktuar në shtojcën nr. 2, "Grupi i parë (I) Minerale metalike" që i bashkëlidhet këtij ligji. Renta minerare llogaritet si detyrim mujor i subjektit taksapagues, në çastin kur ai shet produkte minerare. 5 për qind e të ardhurave nga renta minerare i takojnë pushtetit vendor ku zhvillohet veprimtaria. Të ardhurat nga renta minerare përdoren për investime për njësitë e qeverisjes vendore.

Renta minerare përcaktohet duke shumëzuar vlerën e përgjithshme të shitjes me shumicë të produktit me përqindjen e rentës, sipas përcaktimeve të shtojcës nr. 2, që i bashkëlidhet këtij ligji. Pagesa e rentës minerare bëhet brenda datës 15 të muajit pasardhës, kur janë realizuar shitjet. Degët e doganave në rrethe ngarkohen për arkëtimin e kësaj rente, në rastin e eksportit të produkteve minerare, ndërsa degët e tatimeve ngarkohen për arkëtimin e kësaj rente, në rastin e shitjes së produkteve minerare brenda vendit.

Në rastin kur taksa e rentës minerare aplikohet në përqindje, kjo taksë llogaritet duke shumëzuar vlerën e shitjes së produktit (pa TVSH) me përqindjen e rentës. Kur taksa e rentës minerare aplikohet në vlerë fikse për njësi, shuma e rentës minerare llogaritet duke shumëzuar sasinë e shitjes së produktit me vlerën e rentës minerare. Në rastin e shitjes së mineralit të grupit të parë (I), "Minerale metalike", për përpunim brenda vendit, nga nxjerrësi te përpunuesi, përqindja

e rentës aplikohet në masën sa 1/2 e normës së rentës së përcaktuar në shtojcën nr. 2, mbi vlerën (çmimin) e shitjes, e cila, për efekt të përlogaritjes së rentës minerare, nuk mund të jetë më e vogël se çmimi i shitjes për eksport të mineralit të papërpunuar.

Këshilli i Ministrave përcakton procedurat e arkëtimit të rentës minerare dhe dokumentacionin që duhet të paraqesë i licencuari, eksportuesi, për të vërtetuar çmimin e shitjes. Masa e rentës minerare, e përcaktuar në ligjin minerar, ndryshon sipas paragrafëve të parë dhe të dytë, të pikës 4, të nenit 4, të këtij ligji.

5. Taksa e akteve dhe e pullës caktohet sipas shtojcës nr. 3, e cila i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

6. Taksa e karbonit caktohet në masën 1,5 lekë për litër për benzinën, 3 lekë për litër për gazoilin, 3 lekë për kilogram për qymyrin, 3 lekë për litër për solarin, 3 lekë për litër për mazutin, 3 lekë për litër për vajgurin dhe 3 lekë për kilogram për koks naftë.

7. Taksa e ushtrimit të veprimtarisë së peshkimit caktohet sipas shtojcës nr.4, që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

8. a) Taksa e ambalazheve plastike caktohet në masën 100 lekë/kg dhe zbatohet si në import, ashtu edhe në prodhimin vendas. Vetëm për industrinë vendase të riciklimit, taksa për ambalazhet e prodhuara nga riciklimi i mbetjeve plastike të gjeneruara në vend caktohet në masën 1 lekë/kg.

Këto ambalazhe e kanë përmbajtjen prej lënde të parë plastike, sipas klasifikimit të dhënë në kapitullin 39 të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave në fuqi. Kjo taksë zbatohet për të gjithë artikujt prej plastike të kreut 3923 të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave, në rastet kur importohen veçmas, si dhe kur materiali plastik zë, të paktën, 51 për qind të masës së përgjithshme të ambalazhit që ambalazhon produkte të tjera të klasifikuara në kapitujt, krerët, nënkrerët dhe kodet e tjera tarifore të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave.

Kjo taksë mblidhet nga administrata doganore në momentin e importit, në rastet kur importohen.

Kjo taksë mblidhet nga administrata tatimore në rastet kur produktet me ambalazh plastik prodhohen në territorin e Republikës së Shqipërisë. Administrata tatimore është përgjegjëse për monitorimin e lëndëve të para, granulateve dhe artikujve gjysmë të gatshëm që përdoren në prodhim.

Taksa për ambalazhet e prodhuara nga riciklimi i mbetjeve plastike të gjeneruara në vend caktohet në masën 1 lekë/kg me kusht që subjekti ta provojë këtë fakt me anë të kartës teknologjike të prodhimit, deklaratave të importimit të lëndëve të para, si dhe dokumentimit të blerjeve të lëndëve të para brenda vendit. Kjo taksë mblidhet nga administrata tatimore në rastet kur produktet paktohen, ruhen apo ambalazhohen me ambalazh plastik, të prodhuar nga riciklimi i mbetjeve plastike të gjeneruara në territorin e Republikës së Shqipërisë. Administrata tatimore është përgjegjëse për monitorimin e lëndëve të prodhuara nga riciklimi për qëllime përdorimi të ambalazheve.

b) Taksa e ambalazheve të qelqit caktohet në masën 10 lekë/kg dhe zbatohet si në import, ashtu edhe në prodhimin vendas. Kjo taksë zbatohet për të gjithë artikujt prej qelqi të përmendur në kreun 7010 të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave, në rastet kur importohen veçmas, si dhe kur materiali i qelqit zë, të paktën, 80 për qind të masës së përgjithshme të ambalazhit që ambalazhon produkte të tjera të klasifikuara në kapitujt, krerët, nënkrerët dhe kodet e tjera tarifore të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave.

Kjo taksë mblidhet nga administrata doganore në momentin e importit, në rastet kur importohen. Kjo taksë mblidhet nga administrata tatimore në rastet kur artikujt paktohen, ruhen apo ambalazhohen me ambalazh prej qelqi, të prodhuar në territorin e Republikës së Shqipërisë. Administrata tatimore është përgjegjëse për monitorimin e lëndëve të para që përdoren për prodhimin e ambalazheve të qelqit. Mënyra e monitorimit të lëndëve të para, që përdoren për prodhimin e ambalazheve të qelqit, përcaktohet me udhëzim të ministrit të Financave.

9. Niveli i taksës mbi të drejtën e përdorimit të truallit shtetëror në përdorim, aplikimi, llogaritja dhe pagesa e saj bëhen sipas përcaktimeve të ligjit nr. 10 270, datë 22.4.2010, "Për të drejtën e privatizimit të truallit shtetëror në përdorim dhe për taksën mbi të

drejtën e përdorimit të tij”, të ndryshuar.

10. Taksa mbi primet e shkruara, me përjashtim të primeve të sigurimit për produktet e jetës, shëndetit në udhëtim dhe kartonit jeshil, është 10 për qind e shumës së primit.

11. Pavarësisht nga pagesa e taksës vjetore të mjeteve të përdorura, mbi makinat luksoze zbatohet taksë regjistrimi në masën 70 000 lekë për regjistrim të çdo makine luksoze dhe taksë e përvitshme në masën 21 000 lekë çdo vit.

Taksa e përvitshme për automjetet luksoze është e vlefshme për 365 ditë. Detyrimi për pagimin e taksës i takon pronarit të mjetit. E ardhura nga taksa, për çdo rast, mblidhet nga strukturat e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, Drejtoritë Rajonale, në momentin e vjeljes së taksës vjetore të mjeteve të përdorura. Pronari i mjetit, i cili nuk kryen pagesën e kësaj takse brenda 10 ditëve nga mbarimi i afatit të vlefshmërisë së parashikuar, detyrohet të paguajë një gjobë prej 5 për qind të shumës së detyrimit të papaguar për çdo muaj vonesë, por jo më shumë se 25 për qind për çdo vit.

Neni 4/1

### **Deklarata për pagesën e taksave kombëtare**

*(shtuar me ligjin nr. 178/2013, datë 28.12.2013)*

*(ndryshuar me ligjin nr. 86/2014, datë 17.7.2014)*

*(ndryshuar pika 1 ligjin nr.127/2016, datë 15.12.2016)*

1. Personat fizikë dhe juridikë, subjekte të nenit 4, të këtij ligji, si dhe agjentët e taksave, në rastin kur taksat mblidhen me agjentë, detyrohen:

a) të bëjnë një deklaratë për çdo muaj, jo më vonë se 15 ditë pas përfundimit të muajit për të cilin bëhet deklarimi;

b) të paguajnë taksat kombëtare për atë muaj në datën ose para datës së detyrueshme të deklaratës.

2. Deklarata, sipas shkronjës “a”, të pikës 1, të këtij neni, bëhet në formën dhe përmbajtjen që përcaktohet me udhëzim të Ministrit të Financave.

3. Deklarata për pagesën e taksave kombëtare dorëzohet në një nga mënyrat e parashikuara në ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, pranë drejtorisë rajonale tatimore ku është i regjistruar personi fizik/personi juridik, subjekt i deklarimit të taksës kombëtare.

Neni 5

### **Agjentët e taksave**

*(ndryshuar shkronjat “c” “dh” me ligjin nr. nr.10280, datë 20.5.2010)*

*(ndryshuar shkronjat “b” “c” “dh” me ligjin nr. 10 458, datë 21.7.2011)*

*(shtuar shkronja “ë” me ligjin nr.83/2012, datë 13.9.2012 )*

*(shtuar shkronja “f” me ligjin nr. 86/2014, datë 17.7.2014)*

*(shtuar shkronja “g” me ligjin nr.157, datë 27.11.2014)*

*(shtuar shkronja “gj” me ligjin nr. 141/2015, datë 17.12.2015)*

*(ndryshuar shkronja “g” me ligjin nr.127/2016, datë 15.12.2016)*

Sipas llojit të taksave kombëtare, agjentët që ngarkohen me vjeljen e tyre janë:

a) për taksat portuale, kapiteneria e porteve, e cila i vjel këto taksa drejtpërdrejt ose nëpërmjet agjencive detare, shtetërore apo private;

b) Ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, nëpërmjet degëve të doganave në rrethe, për taksën e qarkullimit për benzinën dhe gazoilin e importuar, si dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, nëpërmjet degëve të saj, për benzinën dhe gazoilin e prodhuar në vend.

c) Për taksën vjetore të mjeteve të përdorura ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor.

ç) për taksën e rentës minerare, organet doganore e tatimore;

d) për taksën e akteve dhe të pullës, zyrat e gjendjes civile;

dh) Ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, nëpërmjet degëve të doganave në rrethe, për taksën e karbonit për benzinën, gazoilin, qymyrin, vajgurin, solarin, mazutin dhe koksin e naftës e importuar, si dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, nëpërmjet degëve të saj, për benzinën, gazoilin, qymyrin, vajgurin, solarin, mazutin dhe koksin e naftës të prodhuar në vend, në bazë të sasive të prodhimit.

e) për taksën e ushtrimit të veprimtarisë së peshkimit ngarkohet Drejtoria e Politikave të Peshkimit dhe degët e saj në rrethe.

ë) për taksën e ambalazheve njëpërdorimshme të plastikës dhe qelqit ngarkohen:

i) Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, nëpërmjet degëve të saj doganore, për vjeljen e kësaj takse në import;

ii) Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, nëpërmjet drejtorive të saj rajonale, për vjeljen e kësaj takse për prodhimin vendas.

f) Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, nëpërmjet drejtorive të saj rajonale, ngarkohet me mbledhjen e taksës mbi të drejtën e përdorimit të truallit shtetëror .

g) Shoqëritë e sigurimit të licencuara nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF) ngarkohen me mbledhjen e taksës mbi primet e shkruara. Për qëllime të mbledhjes së taksës, këto shoqëri e evidentojnë atë veçmas nga primi.

gj) për taksën e regjistrimit fillestar dhe taksën e përvitshme për automjetet luksoze ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor.

#### Neni 6

### **Transferimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifatat kombëtare në drejtorinë rajonale tatimore dhe në llogaritë e njësisve të qeverisjes vendore**

*(ndryshuar me ligjin nr. 178/2013, datë 28.12.2013)*

*(ndryshuar me ligjin nr. 86/2014, datë 17.7.2014)*

Agjentët e taksave deklarojnë dhe transferojnë të ardhurat nga taksat dhe tarifatat për llogari të drejtorisë rajonale tatimore, në përputhje me nenet 4, 4/1 dhe 11/2, të këtij ligji. Për detyrimet e patransferuara të taksave dhe tarifave, për agjentët zbatohen sanksione në përputhje me nenin 117, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

#### Neni 7

### **Taksat që vilen nëpërmjet pullës**

*(ndryshuar fjalë me ligjin nr. 10 458, datë 21.7.2011)*

Taksat kombëtare, që vilen nëpërmjet pullës, janë taksa vjetore e mjeteve të përdorura dhe taksa e akteve të gjendjes civile.

#### Neni 8

### **Komisionet që përfitojnë agjentët e taksave**

*(ndryshuar shkronja “dh” me ligjin nr.10065, datë 29.1.2009)*

*(ndryshuar shkronjat “b” “c” “dh” të pikes 2 me ligjin nr.10280, datë 20.5.2010)*

*(ndryshuar shkronjat “b” “c” të pikes 2 me ligjin nr. 10 458, datë 21.7.2011)*

*(ndryshuar pika 1, ndryshuar, fjalia e parë ë pikës 2 me ligjin nr. 178, datë 28.12.2013)*

*(shtuar shkronja “ë” me ligjin nr. 86/2014, datë 17.7.2014)*

*(shtuar shkronja “f”, në pikën 2 me ligjin nr.157, datë 27.11.2014)*

*(shtuar shkronja “g”, me ligjin nr. 141/2015, datë 17.12.2015)*

1. Taksat arkëtohen nga agjentët e taksave, të përcaktuar në nenin 5 të këtij ligji, dhe transferohen në llogaritë e drejtorive rajonale tatimore dhe të llogarive të njësisve të qeverisjes vendore, sipas përcaktimeve të bëra në këtë ligj.

2. Agjentët e taksave, për shërbimin që kryejnë, përfitojnë komision, të cilin e marrin në rrugë buxhetore. Ky komision llogaritet në përqindje mbi shumat e arkëtuara të taksave që kanë transferuar në llogari të drejtorisë rajonale tatimore dhe në buxhetin e njësisve të

qeverisjes vendore.

- |  |                    |
|--|--------------------|
| a) për taksat portuale (kapitenerisë së porteve)   | 2 për qind;        |
| b) për taksën e qarkullimit,   | 0 për qind.        |
| c) për taksën vjetore të mjeteve të përdorura, Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, 5 për qind. |                    |
| ç) për taksën e akteve dhe të pullës   | 5 për qind;        |
| d) për taksën e rentës minerare (Royalty)  | 0 për qind;        |
| dh) për taksën e karbonit,   | 0 për qind;        |
| e) për taksën e ambalazheve njëpërdorimshme të plastikës dhe qelqit, 0 për qind.   |                    |
| ë) për taksën mbi të drejtën e përdorimit të truallit shtetëror  | 0 (zero) për qind. |
| f) për taksën mbi primet e shkruara  | zero për qind.     |
| g) për taksën e regjistrimit fillestar dhe taksën e përvitshme për automjetet luksoze,                                     | zero për qind.     |

### 3. Komisionet e përfituara përdoren:

- a) në formën e shpërblimit mbi pagën, për vështirësi në punë, sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi;
- b) në formën e pagës, për rastet kur merren punonjës të rinj, për përballimin e vjeljes së taksave;
- c) për mekanizimin, informatizimin, përmirësimin e kushteve të punës, si dhe për përballimin e shpenzimeve për vjeljen e taksave.

## Neni 9

### **Përfashtimet nga pagimi i taksave kombëtare**

*(ndryshuar me ligjin nr.10280, datë 20.5.2010)*

*(ndryshuar pika 1 me ligjin nr. 10 458, datë 21.7.2011)*

*(shtuar pika 1/1 me ligjin nr.120/2013, datë 18.4.2013)*

*(shtuar pika 4 me ligjin nr. 178, datë 28.12.2013)*

*(shtuar pika 4me ligjin nr. 86/2014, datë 17.7.2014)*

*(ndryshuar shkronja "b" e pikës 1, shkronja "c", shtuar pika 6 me ligjin nr. 157, datë 27.11.2014)*

*(shtuar pika 7 me ligjin nr. 141/2015, datë 17.12.2015)*

*(ndryshuar shkronjat "c", "ç" e pikës 1 dhe shkronja "c" e pikës 7 me ligjin nr.127/2016, datë 15.12.2016)*

### 1. Përfashtohen nga pagimi i taksës vjetore të mjeteve të përdorura:

a) mjetet në pronësi të ambasadave dhe organizatave ndërkombëtare, që gëzojnë status diplomatik, të akredituara në Republikën e Shqipërisë, duke zbatuar parimin e reciprocitetit;

b) Personat fizikë apo juridikë, të cilët deklarojnë se nuk do të qarkullojnë me mjete në pronësi të tyre gjatë vitit kalendarik, përkohësisht vetëm një herë brenda një viti kalendarik, ose do të dalin përfundimisht nga qarkullimi dhe që dorëzojnë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Transportit Rrugor, targën dhe lejen e qarkullimit, me kusht që të kenë paguar detyrime të prapambetura, nëse kanë.

c) ) pagesat e taksës së mjeteve të bllokuara me vendim të gjykatës, të prokurorisë, për periudhën në të cilën mjete ka qenë i bllokuar, dhe pagesat e taksës së mjeteve të vjedhura, të djegura, të shkatërruara nga aksidentet, të vërtetuara nga organet e prokurorisë.

ç) autoveturat tip deri në 4+1 vende dhe me cilindrata jo më shumë se 2500 kubikë, kur këto mjete kalojnë në zotërim të invalidëve e të veteranëve të luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar, invalidëve të punës, të verbërve, invalidëve paraplegjikë dhe tetraplegjikë, që e fitojnë këtë status në bazë të ligjeve përkatëse, dhe përdoren vetëm për nevojat e tyre personale e jo për veprimtari private;

d) makinat bujqësore.

1/1. Falen të gjitha detyrimet e prapambetura të taksës vjetore të qarkullimit rrugor për mjetet e sekuestruara apo të konfiskuara me vendim të formës së prerë të gjykatës, të cilat i kalojnë në administrim Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të

Konfiskuara për qëllime përdorimi apo rishitjeje.

2. Shfuqizuar.

3. Përfshihen nga pagimi i taksës së akteve dhe të pullës:

a) veprimet zyrtare, që kërkohen nga autoritetet e huaja, në bazë reciprociteti;

b) regjistrimi i lindjeve dhe i vdekjeve, si dhe shënimet në regjistrat e gjendjes civile.

4. Përfshihen nga pagimi i taksës së ambalazheve të plastikës dhe të qelqit, sipas përcaktimeve të nenit 4:

a) importimi për nevoja zyrtare dhe personale, në kuadër të misioneve diplomatike dhe konsullore, përfshirë edhe konsujt e nderit, si dhe misionet speciale të akredituara në Shqipëri;

b) importimi për nevoja zyrtare dhe personale të organizmave ndërkombëtare, të njohur si të tillë nga Republika e Shqipërisë e sipas limiteve dhe kushteve të përcaktuara në konventat ndërkombëtare, në bazë të të cilave janë formuar këta organizma ose në marrëveshjet reciproke;

c) importimi i produkteve për qëllime të ndihmave humanitare;

ç) ambalazhet plastike të importuara veçmas apo kur ambalazhojnë artikuj të tjerë të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave si më poshtë:

i) arkat plastike;

ii) fuçitë me kapacitet  $\geq 20$  litra;

iii) kapakët e CD-ve dhe DVD-ve;

iv) kutitë paketuese dhe tasat për ushqime;

v) kutitë e votimit;

vi) mbajtëset për kafe, çaj, erëza;

vii) mbajtëset për ushqimet, si: marmelatë, bukë, salcë, fruta, gjalpë, vaj etj.;

viii) paketuesit për serumet, gjakun dhe barnat mjekësore;

d) ambalazhe qelqi, të importuara veçmas apo kur ambalazhojnë artikuj të tjerë të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave si më poshtë:

i) ampulat për barnat mjekësore;

ii) shishet për mbajtjen e serumit, gjakut dhe barnave mjekësore;

dh) ambalazhet plastike dhe qelqi, të vendosura nën regjime doganore pezulluese.

5. Taksa mbi të drejtën e përdorimit të truallit shtetëror nuk zbatohet mbi trojet turistike, mbi objektet dhe trojet e pranuar në proces legalizimi apo mbi trojet shtetërore, të dhëna me qëllim investimin mbi to, të cilat rregullohen nga ligje të tjera.

Përfshihen nga pagesa e vlerës së qirasë së truallit në përdorim, nga momenti i privatizimit, blerjes apo ndërtimit të objekteve deri në datën 7.6.2010, të gjitha subjektet apo individët që janë objekt i ligjit nr. 10 270, datë 22.4.2010, "Për të drejtën e privatizimit të truallit shtetëror në përdorim dhe për taksën e përdorimit të tij", të ndryshuar, të cilët bëjnë kërkesë për privatizimin e këtij trualli dhe paguajnë në mënyrë të menjëhershme vlerën e plotë të tij."

6. Përfshihen nga pagimi i taksës së qarkullimit dhe taksës së karbonit anijet e peshkimit. Sasitë, kushtet dhe kriteret përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave brenda datës 15 janar 2015.

7. Përfshihen nga pagimi i taksës së përvitshme dhe të regjistrimit të mjeteve luksoze:

a) mjetet në pronësi të ambasadave dhe organizatave ndërkombëtare, që gëzojnë status diplomatik, të akredituara në Republikën e Shqipërisë, duke zbatuar parimin e reciprocitetit;

b) personat fizikë apo juridikë, të cilët deklarojnë se nuk do të qarkullojnë me mjete në pronësi të tyre gjatë vitit kalendarik, përkohësisht vetëm një herë brenda një viti kalendarik, ose do të dalin përfundimisht nga qarkullimi dhe që dorëzojnë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Transportit Rrugor targën dhe lejen e qarkullimit, me kusht që të kenë paguar detyrime të prapambetura, nëse kanë;

c) c) pagesat e taksës së mjeteve të bllokuara me vendim të gjykatës, të prokurorisë, për periudhën në të cilën mjete ka qenë i bllokuar, dhe pagesat e taksës së mjeteve të vjedhura, të djegur, të shkatërruara nga aksidentet, të vërtetuara nga organet e prokurorisë.

ç) të gjitha detyrimet e prapambetura të taksës së përvitshme dhe të regjistrimit të mjeteve luksoze të sekuestruara apo të konfiskuara me vendim të formës së prerë të gjykatës, të cilat i



kalojnë në administrim Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara për qëllime përdorimi apo rishitjeje.

Neni 10

### **Shkeljet dhe sanksionet**

1. Shkeljet e dispozitave të këtij ligji, që përbëjnë kundërvajtje administrative, përcaktohen sipas ligjit për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë dhe, kur nuk përbëjnë vepër penale, dënohen po sipas ligjit të procedurave tatimore në Republikën e Shqipërisë.

2. Procedurat e ankimit dhe të ekzekutimit të masave administrative bëhen në përputhje me ligjin për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë.

Neni 11

### **Tarifa shërbimi**

*(ndryshuar shkronja "c" e pikës 1 dhe pika 2 me ligjin nr.10065, datë 29.1.2009)*

*(shfuqizuar shkronja "ë" me ligjin nr.10280, datë 20.5.2010)*

*(shtuar shkronja "ë" me ligjin nr. 10 458, datë 21.7.2011)*

*(ndryshuar shkronja "ç" me ligjin nr. 178, datë 28.12.2013)*

1. Përveç tarifave të shërbimit, të përcaktuara në aktet e tjera ligjore dhe nënligjore, quhen tarifa shërbimi edhe:

a) tarifa e pajisjes me leje drejtimi e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor;

b) tarifa për përdorimin e aparateve televizive e Radiotelevizionit Publik Shqiptar;

c) ) tarifë shërbimi konsullore e Ministrisë së Punëve të Jashtme apo ambasadave tona jashtë vendit.

ç) tarifa për veprime e shërbime të administratës gjyqësore e Ministrisë së Drejtësisë, prokurorisë dhe noterisë.

d) tarifa për shërbimet e transmetimeve radiotevizive e Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit (KKRT);

dh) tarifa për pajisjen me pasaportë lundrimi e kapitenerisë së porteve;

e) tarifa për shërbimet e radiokomunikimit e Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP);

ë) tarifa e shërbimit për qarkullimin e mjeteve të huaja të transportit të udhëtarëve të më shumë se 20 personave, përfshirë edhe drejtuesin e mjetit, si dhe të mjeteve të transportit të mallrave me ngarkesë apo pa ngarkesë përcaktohet me reciprocitet.

f) tarifa për kalimin me avion të kufirit të Republikës së Shqipërisë.

2. Nivelet minimale të tarifave të shërbimit, të përcaktuara në paragrafin e parë të këtij neni, si dhe agjentët tatimorë e komisionet përkatëse të tyre përcaktohen me udhëzim të përbashkët të Ministrit të Financave dhe të titullarëve të institucioneve përkatëse.

Neni 11/1

### **Përfshirjet nga pagesa e tarifave të shërbimit**

*(Shtuar me ligjin nr.10280, datë 20.5.2010)*

1. Personat që gëzojnë statusin e invalidit, në bazë të ligjit nr. 7889, datë 14.12.1994 "Për statusin e invalidit", të ndryshuar, statusin e invalidit të luftës, në bazë të ligjit nr. 7663, datë 20.1.1993 "Për statusin e invalidit të luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar", statusin e veteranit të luftës, në bazë të ligjit nr. 7874, datë 17.11.1994 "Për statusin e veteranit të luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar", të ndryshuar, apo statusin e të verbrit, në bazë të ligjit nr. 8098, datë 28.3.1996 "Për statusin e të verbrit", përfshihen nga:

a) tarifa për shërbimet konsullore e Ministrisë së Punëve të Jashtme apo e ambasadave tona jashtë vendit;

b) tarifa për përdorimin e aparateve televizive e Radiotelevizionit Publik;

c) tarifa për pajisjen me pasaportë lundrimi e Kapitenerisë së Porteve;  
ç) tarifa e pajisjes me leje drejtimi e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor.

2. Personat e sipërpërmendur nuk i përfitojnë këto përjashtime nëse kryejnë veprimtari private si persona fizikë apo juridikë.

Neni 11/2

### **Deklarata për pagesën e tarifave kombëtare**

*(Shtuar me ligjin nr. 86/2014, datë 17.7.2014)*

1. Personat fizikë dhe juridikë, subjekte të pagesës së tarifave kombëtare, në përputhje me nenin 11, të këtij ligji, si dhe agjentët e tarifave kombëtare, në rastin kur tarifat mbliidhen me agjentë, detyrohen:

a) të bëjnë një deklaratë për çdo muaj, jo më vonë se 15 ditë pas përfundimit të muajit për të cilin bëhen deklaratimet;

b) të paguajnë tarifën kombëtare për atë muaj në datën ose para datës së detyrueshme të deklaratës.

2. Deklarata, sipas shkronjës “a”, të pikës 1, të këtij neni, bëhet në formën dhe përmbajtjen që përcaktohet me udhëzim të Ministrit të Financave.

3. Deklarata për pagesën e tarifës kombëtare dorëzohet në një nga mënyrat e parashikuara në ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, pranë drejtorisë rajonale tatimore ku është i regjistruar personi fizik/personi juridik, subjekt i deklaratimit të tarifës kombëtare.

Neni 12

### **Shfuqizimet**

Ligji nr.8977, datë 12.12.2002 “Për sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, shfuqizohet.

Neni 13

Ngarkohet Ministria e Financave të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji.

### **Dispozitë kalimtare**

*(shtuar me ligjin nr.83/2012, 13.9.2012 )*

Të gjithë tatimpaguesit, të cilët kanë paguar, pranë administratës doganore, akcizë për ambalazhet e plastikës dhe të qelqit, sipas ligjit nr. 8976, datë 12.12.2002 “Për akcizat”, të ndryshuar, dhe janë të pajisur me autorizim si tatimpagues akcize dhe kanë magazinë tatimore, në rast të shitjes së produktit (për të cilin është paguar akcizë në import) pas datës 1 tetor 2012 nuk janë subjekt i pagesës së taksave të përcaktuara në nenet 1 dhe 2 të këtij ligji. Administrata tatimore dhe ajo doganore kryejnë verifikimet rast pas rasti.

### **Dispozita kalimtare**

*(shtuar me ligjin nr.120/2013, 18.4.2013) )*

Pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, të gjithë pronarët e mjeteve, që nuk kanë paguar taksën vjetore të mjeteve të përdorura, paguajnë sipas këtij ligji. Në rast se pagesa bëhet brenda datës 30 qershor 2013, ata përjashtohen edhe nga penaltetet për vonesë në pagesën e taksave. Aplikimi i penaltetit për vonesë në pagesën e taksave, për të gjitha mjetet, që u ka kaluar afati i vlefshmërisë së taksave, pavarësisht kur e kanë kryer pagesën e taksave, fillon nga data 1 janar 2014.

Neni 14  
**Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.5862, datë 1.8.2008 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë  
Bamir Topi**

SHTOJCA NR.1  
MASA E TAKSËS VJETORE TË QARKULLIMIT RRUGOR TË PËRVITSHËM TË  
MJETEVE

Nr.	Tipi i Mjetit	Masa e taksës në lekë
1	Ciklomotorë	0
2	Motomjete	500
3	Autoveturë: <= 4+1 vende, benzinë <= 4+1 vende, naftë > 4+1 deri me 8+1 vende, benzinë > 4+1 deri me 8+1 vende, naftë	7 000 10 000 25 000 35 000
4	Automjet transport i përzier: <= 3 tonë > 3 tonë deri 3.5 tonë	26 000 37 000
5	Kamionë: Mbi 3.5 tonë – 7.5 tonë Mbi 7.5 tonë – 18 tonë Mbi 18 tonë	46 000 64 000 92 000
6	Autobus: Nga 8+1 deri 32+1 vende Mbi 32+1 deri 42+1 vende Mbi 42+1 vende dhe artikulare	34 000 43 000 53 000
7	Automjet për përdorim të veçantë: Deri 3.5 tonë Mbi 3.5 tonë deri 7.5 tonë, Mbi 7.5 tonë deri 18 tonë Mbi 18 tonë	37 000 46 000 64 000 92 000
8	Automjet për transport të veçantë: <= 3.5 tonë Mbi 3.5 tonë deri 7.5 tonë Mbi 7.5 tonë deri 18 tonë Mbi 18 tonë	37 000 46 000 66 000 106 000
9	Tërheqës rrugor	50 000
10	Autokamp	46 000
11	Rimorkio: Deri 750 kg (karrel) shtojcë Mbi 750 kg deri në 1500 kg Mbi 1500 kg deri 7000 kg Mbi 7000 kg	5 000 8 000 10 000 17 000
12	Gjysmë rimorkio: <= 7000 kg dhe > 7000 kg	36 000
13	Makina bujqësore: Deri 3.5 tonë	2 000

	Mbi 3.5 tonë deri 7.5 tonë Mbi 7.5 tonë deri 18 tonë Mbi 18 tonë	2 000 2 000 2 000
14	Makina teknologjike: Deri 3.5 tonë Mbi 3.5 tonë deri 7.5 tonë Mbi 7.5 tonë deri 18 tonë Mbi 18 tonë	20 000 38 000 48 000 54 000
15	Mjete rrugore të veçanta: Deri 3.5 tonë Mbi 3.5 tonë deri 7.5 tonë Mbi 7.5 tonë deri 18 tonë Mbi 18 tonë	37 000 46 000 64 000 92 000

**SHTOJCA NR. 2**  
**RENTA MINERARE SIPAS KLASIFIKIMIT**  
*(ndryshuar me ligjin nr.10280, datë 20.5.2010)*  
*(ndryshuar me ligjin nr.141/2015, datë 17.12.2015)*  
*(ndryshuar me ligjin nr.127/2016, datë 15.12.2016)*

Nr.	Emërtimi i grupit të mineraleve sipas ligjit mineralar	Përqindja e rentës minerare
<b>Grupi i parë (I) MINERALET METALIKE</b>		
1	Mineralet e Argjendit	10 %
2	Mineralet e Arit	10 %
3	Mineralet e Bakrit	6 %
4	Mineralet e Kromit për eksport	6 %
5	Mineralet e Nikelit (nikel-silikat)	6 %
6	Mineralet e Hekurit (hekur-nikeli)	5 %
7	Mineralet Plumbit	5 %
8	Mineralet e Zinkut	7 %
9	Gjithë mineralet e tjera metalike	4 %
<b>Grupi i dytë (II) MINERALET JOMETALIKE</b>		
10	Të gjitha mineralet jometalike	4 %
<b>Grupi i tretë (III) QYMYRET DHE BITUMET</b>		
11	Qymyret	19 940 lekë/ton
12	Bitumet	2 371 lekë/ton
13	Rërat bituminoze	117 lekë/m <sup>3</sup>
14	Reshpet naftore	117 lekë/m <sup>3</sup>
15	Pirobitumet	186 lekë/ton
16	Qymyr guri	200 lekë/ton
<b>Grupi i katërt (IV) MINERALET DHE MATERIALET E NDËRTIMIT</b>		

17	Graniti	5 850 lekë/m <sup>3</sup>
18	Gëlqerorët	47 lekë/m <sup>3</sup>
19	Gabrot	47 lekë/m <sup>3</sup>
20	Bazaltet	73 lekë/ton
21	Konglomerate	7 %
22	Mermeri	4 095 lekë/m <sup>3</sup>
23	Pllakat e ndërtimit	
23.1	<i>Pllaka guri</i>	228 lekë/m <sup>3</sup>
23.2	<i>Pllaka ranore</i>	1 456 lekë/m <sup>3</sup>
23.3	<i>Pllaka graniti</i>	6 825 lekë/m <sup>3</sup>
23.4	<i>Pllaka mermeri</i>	4 550 lekë/m <sup>3</sup>
23.5	<i>Pllaka të tjera</i>	6 000 lekë/ton
24	Pllagjiogranitet	5 %
25	Ranoret	491 lekë/m <sup>3</sup>
26	Serpentinitet	47 lekë/m <sup>3</sup>
27	Travertinat	2 925 lekë/m <sup>3</sup>
28	Traktolitet	2 925 lekë/m <sup>3</sup>
29	Gips	21 lekë /ton
30	Alabastër	423 lekë/m <sup>3</sup>
31	Argjila (prodhim çimento, tjegulla, tulla etj.)	15 lekë/ton
32	Argjila (prodhim diga hidrocentrali)	104 lekë/m <sup>3</sup>
33	Argjil (për prodhim qeramike)	23 lekë/ton
34	Rërë lumi	98 lekë/m <sup>3</sup>
35	Inerte lumore	42 lekë/m <sup>3</sup>
36	Gjithë mineralet e tjera të grupit të katërt	104 lekë/m <sup>3</sup>
<b>Grupi i pestë (V) GURËT E ÇMUAR</b>		
37	Gjithë mineralet e grupit të pestë	10 %
<b>Grupi i gjashtë (VI) GURËT GJYSMË TË ÇMUAR DHE OPALI</b>		
38	Gjithë mineralet e grupit të gjashtë	10 %
39	<b>Grupi i shtatë (VII) NAFTA DHE GAZI</b>	10 %



SHTOJCA NR.3  
TAKSA E AKTEVE DHE E PULLËS  
(ndryshuar me ligjin nr.10145, datë 28.9.2009)  
(ndryshuar me ligjin nr.141/2015, datë 17.12.2015)

MASA E TAKSËS

1. Për lëshimin e certifikatave për përdorim brenda vendit  
50 lekë
2. Për lëshimin e certifikatave për përdorim nga autoritetet e huaja  
200 lekë
3. Për regjistrimin e shtetasve të huaj pas dhënies së shtetësisë shqiptare  
2 000 lekë
4. Për procedurën e ndryshimit të emrit/mbiemrit  
1 000 lekë
5. Për mbajtjen e akteve të lidhjes së martesës  
000 lekë
6. Për procedurën për veçim/bashkim familjeje  
1 000 lekë

1

SHTOJCA NR.4  
TAKSA VJETORE PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARISË SË  
PESHKIMIT

	Lekë në vit
<b>I. Peshkimi detar (për 1 anije)</b>	
1. Peshkimi detar fundor:	
- anije 160-200 HP	40 000
- anije 201-410 HP	50 000
- anije mbi 410 HP	80 000
2. Peshkimi pellagjik me tratavolante:	
- anije 160-200 HP	20 000
- anije 201-410 HP	30 000
- anije mbi 410 HP	40 000
3. Peshkimi pellagjik me rrethime:	
- anije 80-200 HP	10 000
- anije 201-410 HP	20 000

- anije mbi 410 HP	30 000
4. Peshkimi pellagjik dhe fundor:	
- anije 160-200 HP	40 000
- anije 201-410 HP	60 000
- anije mbi 410 HP	90 000
5. Peshkimi me mjete selektike:	
- anije 40 - 80 HP	15 000
- anije 81-160 HP	25 000
- anije 161-200 HP	40 000
- anije 201-410 HP	50 000
- anije mbi 410 HP	80 000
6. Peshkimi i molusqeve bivalvore (i autorizuar)	60 000

## **II. Peshkimi artizanal me mjete të lehta:**

1. Peshkimi në bregdet (për një sanall dhe me motor deri në 40HP)	7 000
2. Peshkimi në lagunat bregdetare:	
- në lagunë (1 lundror)	10 000
- në dajlane (1 peshkatar)	12 000
3. Peshkimi në ujëra të brendshme:	
- aktiv (1 lundror)	5 000
- në dajlane e prita (1 peshkatar)	8 000
4. Grumbullimi i molusqeve bivalvore me mjete të lehta (gabie) për 1(një) peshkatar	20 000

## **III. Peshkimi sportiv në det**

me mjete lundruese (për 1 mjet)	40 000
---------------------------------	--------

## **IV. Akuakultura:**

1. Kultivimi i midhjeve për një impiant	10 000
2. Kultivimi i peshqve me impiante në det, në liqene, në rezervuarë	1 000
3. Akuakulturë me impiante në tokë	10 000

**Shënim:** Për anijet e huaja që marrin licencë peshkimi në ujërat tona territoriale, taksa e lejes së ushtrimit të veprimtarisë është sa dyfishi i anijeve shqiptare. Nuk i nënshtrohen kësaj takse anijet e autorizuar nga Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave (Drejtoria e Politikave të Peshkimit), që do të peshkojnë për qëllime studimore e shkencore.